



REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIK OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 298/2014
Datë: 16 tetor 2014

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi të Ligjit për Këshillin Prokurorial, Planin e veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me datën 16 tetor 2014 mori këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet Prokuroria e Apelit, të analizoj dhe të paraqet raport vlerësues me shkrim para Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me të gjitha Hudhjet dhe Pushimet në rastet e korrupsionit nga Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë Speciale e Republikës së Kosovës.
- II. Prokuroria e Apelit do të vlerësoj të gjitha Hudhjet dhe Pushimet për rastet e korrupsionit nga Plani i Veprimit lidhur me ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit.
- III. Prokuroria e Apelit do të vlerësoj po ashtu kallëzimet penale të parashtuara nga agjencitë që zbatojnë ligjin në Kosovë, në të gjitha rastet e hudhjeve dhe pushimeve nga paragrafi 2 i këtij Vendimi.
- IV. Obligohet Prokuroria e Apelit që raportin vlerësues me shkrim ta paraqes tek Këshilli Prokurorial i Kosovës jo më larg se në fund të muajit nëntor 2014.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Sylë Hoxha

Kryetar i Këshillit Prokurorial



T'i dërgohet:

- Kryeprokurorit të PA;
- Kryeprokurorëve të PTH-ve dhe PSRK,
- Sekretariatit të ZKPSH dhe NJSHP-së;
- Arkivit të PSH-së.